

Marcel Courthiade

Themelet e shkrimit të gjuhës rome të perbashkët

– pjesa e parë: gjendja natyrore dhe parimet e veprimit –

Gjuha rome, bashkë me nja dhjetë gjuhë të tjera (midis të cilave më të njohurat janë gjuha hindi me variantin e saj të arabizuar urdu, gjuha bangla e Bengalit, nepalishtja, gjuha singhaleze e Sri-Lankës, etj ...) përbëjnë degën indiane të grupit indoarian të gjuhëve indoevropiane. Megjithëse Rromët kishin pohuar origjinën e tyre indiane disa herë mbas mbërritjes së tyre në Evropë, siç dëshmojnë mjaft dokumente nga periudha midis viteve 1422 e 1630, kjo u mor seriozisht parasysh vetëm në fund të shekullit XVIII kur u zbulua lidhja e ngushtë e gjuhës rome me ato indiane. Kjo lidhje mbështetet midis të tjerave:

- 1) në përputhjen fonologjike, sidomos në praninë në rromishte të të arspiruarave *ph*, *th* (= shqip [t'h])¹, *çh* (=shqip [çh]) e *kh*, që janë karakteristike për gjuhët indiane;
- 2) në mjaft ngjashmëri për sa i përket përpjesëtimit të fonemave. Psh. fonemat *c*, *f* dhe *z* (= shqip [zh]) kanë një frekuencë shumë të ulët (rreth 0% në një provë dhjetëminutëshe me bisedë të lirë në të folmen rome të ashtuquajtur t'haregonishte të Prishtinës), ndërsa fonema *ʒ* (= shqip [xh]) në po atë provë ka një frekuencë prej 7,2 %, dy shifra që u afrohen atyre të gjuhëve indiane; përveç kësaj, *ʒ*-ja takohet vetëm në fjalët e fondit të lashtë dhe shumë rrallë në huazimet. Dihet se kjo fonemë është e shpeshtë në gjuhët indiane;
- 3) në disa qindra rrënjë të përbashkëta, që përbëjnë 80 % deri 90 % të fjalorit themelor të pasqyruar në listën e Swadeshit;
- 4) në përputhjen e formave të një sëre mbaresash emërore dhe mbiemërore;
- 5) në dukurinë e përshtatjes së formës pronore me sendin e pronuar sipas gjinisë, numrit dhe trajtës, si një mbiemër – një dukuri karakteristike për gjuhët indiane;
- 6) në përdorimin në gjuhën rome të prapafjalëve, që janë karakteristike për gjuhët indiane, përbri parafjalëve, që janë karakteristike për gjuhët evropiane;
- 7) në disa raste përputhjeje në sistemin foljor.

¹ Në original, fjalët rome jepeshin në një variant të atëhershëm të alfabetit rom, në përpunim e sipër nga grupi i Bashkimit ndërkombëtar të Rromëve, kurse në këtë version *online* - jepen për arsye qartësie në alfabetin rom të përbashkët të miratuar nga ky Bashkim në kongresin e Varshavës më 8 Prill 1990. Shpjegimet shqiptimore me shkronja shqip jepen në kllapa katrore, psh. [çhavo].

I. SHTRIRJA E GJUHËS RROME

Në gjuhën rrome flasin romët e shpërndarë në tërë Evropën, në Turqi e pak në Persi, si edhe në të dy Amerikat. Disa fise kanë humbur gjuhën amtare, sidomas në gadishullin iberik, si pasojë e inkuizionit që i detyronte ata të përdornin gjuhën kastelane, emra të krishterë dhe të merrnin fenë e mbretërve “shumë katolike”. Dënoheshin me prerje të veshëve në rast mosbindjeje. Prandaj romët e gadishullit iberik kanë ruajtur vetëm disa qindra fjalë me prejardhje indiane dhe i përdorin si një fjalor sekret të kombinuar me trajtat gramatikore të gjuhës së vendit (spanjisht, katalanisht, baskisht e më pak okcitanisht e portugalisht). Kjo e folme sekrete, që është me tepër një zhargon sesa një gjuhë, quhet “kallo” (sp. “calo” nga rromishtja *kalo* “i zi”) ose “çipi kali” (sp. “chipi cali” nga rromishtja *çhib kali* “gjuhë e zezë”). Në dokumentet e shekullit XIX, janë mbledhur ende disa qindra fjalë të këtij zhargoni “*kalo*” por sot më pak se njëqind prej tyre përdoren akoma. Një gjë e ngjashme ndodhi në Britaninë e Madhe, ku afro treçerekë i popullsisë rrome (gjithsej rreth 100 000 vetë) përdor të ashtuquajturin anglo-rromani, që është një zhargon me disa qindra rrënjë rrome të kombinuara në një gramatikë angleze, siç e ilustron shembulli më poshtë:

“My *dadus dikked a mush 'vell from the gav;*
he was *hoino and penned my dadus our*
matchegas was (sic) mewing all the rati, so
he could not *sutti*”.

«*Babai im pa një burrë që vinte nga fshati;*
ishte i *zëmeruar* dhe i *tha babait së macet*
tona mjaullinin tërë *natën* dhe ai nuk *flinte*
dot».

Rromët në vendet gjermanike kanë ruajtur më mirë gjuhën e vet, por një pjesë të konsiderueshme të trajtave gramatikore e kanë huazuar nga dialektet gjermane. Këta rromë quhen vetë *manus* dmth. “njeri” (krhs. në sanskritishten dhe në disa gj. indiane moderne *manus*, *manus* «njeri»).

Në Evropën lindore dhe juglindore, fare pak fise rrome kanë humbur gjuhën e vet dhe flasin vetëm në gjuhën e vendit ku jetojnë, kurse pjesa dërmuese e rromëve (zakonisht rreth 95% në vitet '80) e mban rromishten si mjet të parë komunikimi, që nga vendet ballkanike e deri në Poloni dhe nga vendet ballte e skandinave e deri në Itali, Oksitani e Francë. Atje, përzihen rromë të arratisur qëmoti nga Spanja (ata rromë quhen vetë *calos* ose *gitanos* [hitanos] e rromishten e kanë humbur ata si gjuhë amtare) me rromët e ardhur prej Turqisë në Mesjetë ose të larguar nga Evropa qendrore apo Rusia për arsye të ndryshme. Pranohet që folësit e rromishtes janë pesë deri në tetë milionë njerëz, të shpërndarë nëpër botë, nga 10 milionë që janë rromët gjithësej; shumica e tyre jeton në Evropë.

II. NDËRKUPTIMI MIDIS TË FOLMEVE RROME

Ndërkuptimi midis rromëve nuk paraqet ndonjë vështirësi të posaçme në nivelin e bisedave për çështjet familjare dhe konkrete, sepse fjalori themelor është në masë të gjerë i përbashkët. Kështu për shembull *vesh-it* dhe *nuse-s*, kudo u thuhet *kan* dhe *bori*. Vështirësitë shfaqen kur biseda prek çështjet e jetesës moderne, mbasi secili grup rromësh ka huazuar nga gjuha e vendit ku jeton fjalorin që i përket kësaj sfere; kështu psh. për nocionin “dëftesë aftësie që ka një shofer për të ngarë një automjet”, përdoren huazime vendëse të ndryshme si *patënta*, *dòzvola* ose *dozvola*, *pozvalitèlno*, *permisos* ose *karnèto* (më popullor), *jogošitvànjos* (sot *jarmúvededóvo*), *pravojázdy*, *motorisqo preukázis*, etj... në vendet ku flitet përkatësisht shqip, serbokroatisht a maqedonisht, bullgarisht, rumunisht, hungarisht, polonisht, sllovakisht, etj., ndërsa për nocionin “shtesë rroge si ndihmë për fëmijë”, përdoren në po ato vende fjalët *kombesimi*, *deçji* (*d.*), *dobavki*, *alokàcie*, *çaladi-potlek*, *dodatkos*, *prídavka*, etj ... gjë që natyrisht e rëndon ndërkuptimin midis rromëve të shteteve të ndryshëm.

Për të vlerësuar kompaktësinë e gjuhës rrome, janë bërë mjaft studime, speshherë empirike, por edhe me bazë sistematike, siç është rasti i studimeve dialektometrike. Këto të fundit kanë vënë në dukje se pjesa dërmuese e të folmeve rrome të Evropës qëndrojnë midis tyre në marrëdhënie si dialekte me dialekte dhe jo në marrëdhënie si gjuhë me gjuhë tjetër, gjë që shprehet nëpërmjet “distancës” *d* që mund të llogaritet midis dy të folmeve të caktuara. Në rastin e të folmeve rrome, distanca *d* është më e shkurtër sesa distanca unitare e referencës, duke qenë se një *d* prej “1” është distanca mbi të cilën secila e folme në fjalë konsiderohet si një gjuhë e veçantë, kurse një distancë *d* me një vlerë më të ulët se “1” tregon për dialekte të ndryshme brenda për brenda të njëjtës gjuhë.

III. VLERESIMI I DISTANCAVE NDËRDIALEKTORE (DIALEKTOMETRIA STATISTIKORE)

Tiparet dalluese që përdoren për të krahasuar dy të folme janë të disa niveleve: fonologjikë, leksikorë, morfologjikë, sintaksorë, frazeologjikë, etj ... Deri tani nuk kemi ne gjendje të shprehim me shifra shkallën e divergjencave sintaksore apo frazeologjike midis tyre, kurse ato fonologjike e leksikore pasqyrohen mjaft mirë me anë të së ashtuquajturës “distance leksikostatistike” d , e cila llogaritet në bazë të treguesit të përbashkësisë T , si shpjegohet më poshtë:

Në të dy të folmet nën shqyrtim, kërkohet si shprehen 200 *nocione themelore* të zgjedhura për thjeshtësinë e tyre, d. m.th. që kanë një probabilitet të lartë që të shprehen me një fjalë të thjeshtë (d.m.th. jo me një togfjalë ose disa sinonime – kjo pavarësisht për cilën gjuhë të botës bëhet fjalë: nocione të tilla janë psh. DIELL, TYM, BRI, etj ...). Autori i listës së parë të këtij tipi, një listë prej 215 nocionesh themelore, qe Morris/Maurice Swadeshi, i cili hulumtonte gjuhët autoktone të Amerikës. Nganjëherë është kritikuar numri i nocioneve në listë si tepër i kufizuar. Në fakt kjo kritikë nuk qëndron për arsye se në qoftë se merren më shumë nocione, saktësia e vlerësimit nuk rritet por rritet rreziku i pasaktësisë nga hyrja e nocioneve kritike. Nga ana tjetër, një mostër më e vogël nuk do të ishte e mjaftueshme e përsëri do të rriste rrezikun e pasaktësisë, kjo nga disa dukuri të tjera.

Për t'u përshtatur veçorive të secilit grupi gjuhësh, lejohet të ndryshohet fare pak lista-bazë, gjithnjë duke qendruar brenda kufijve sa më të ngushta, që të jenë të mundur më vonë krahasime me gjuhë të tjera. Kështu, për dialektometrinë rrome, është hartuar mbi bazën e Swadeshit një liste prej 200 nocionesh, duke hequr disa nocione si psh. “to stand” (rri më këmbë) , mbasi në mjaft dialekte rrome (si edhe në shqip) nuk ekziston ky kuptim si nocion i thjeshtë, i shprehur me një fjalë.

Etapa e dytë është llogaritja e shkallës së ngjashmërisë për secilin nocion midis fjalëve të përdorur në secilën prej të folmeve, nga vlera 4 (ngjashmëri e plotë) deri në 0 (fjalët s'kanë lidhje të dukshme midis tyre). Për çdo diferencë fonematike hiqet një pikë, si psh.:

shkallë	diferenca	Shembuj me gjuhën shqipe		Shembuj me gjuhën rrome		
		Toskërisht	Gegënisht	Dialekt X	Dialekt Y	kuptim
4	1	barku	barku	bori	bori	“nuse”
3	2	emri	emni	gilavel	gilabel	“këndon”
2	3	ngjeshur	njeshun	vando	jarro	“vezë”
1	4	ëmbëlsira	ãmëlcina	nikavel	ikalëla	“nxjerr”
0	but	qumësht	tômël	men	korr	“qafë”

Kur njëra prej të folmeve paraqitet me një tipar të panjohur në të folmen tjetër, hiqet vetëm 1/2 pikë (psh. në shqip hi = hî – mbasi zanorja î është e pamundur në toskërisht, sepse hundëzimi nuk ekziston si tipar një dialektin përkatës).

Llogaritet atëherë treguesi i përbashkësisë T në përqindje, i cili është 25 herë mesatarja e të gjithë vlerave të mbledhura kështu e që shprehet në përqindje. Prej tij mund të nxirret distanca d midis të folmeve me anë të formulës:

$$d = \frac{7}{3} \left(\frac{1}{T} - 1 \right). \text{ Në këtë mënyrë, kemi korrespondenca si më poshtë:}$$

- një treguesi të përbashkësisë $T = 100\%$ i pergjigjet një distancë d prej 0 U
- një treguesi të përbashkësisë $T = 0\%$ i pergjigjet një distancë d prej ∞
- një treguesi të përbashkësisë $T = 70\%$ i pergjigjet një distancë d prej 1 U

Vlera 70% është e ndërmjetme midis treguesve ndërgjuhësorë ($T < 70\%$) dhe treguesve ndërdialektorë ($T > 70\%$). Prandaj vlera 70 % është zgjedhur si vlerë themelore për të përcaktuar distancën unitare ($d_0 = 1 U$) e si pasojë del koeficienti $7/3$ në formulën e distancës. Kështu dy të folme konsiderohen si gjuhë të veçanta kur distanca d midis tyre është $> 1 U$ dhe si dialekte të një gjuhe kur $d < 1 U$.

Jashtë fushës së romishtes kemi për shembull:

- $d = 0,4 U \rightarrow$ distanca midis gegërishtes dhe toskërishtes
- $d = 0,86 U \rightarrow$ midis turqishtes së Prizrenit dhe asaj letrare
- $d = 1,20 U \rightarrow$ midis maqedonishtes letrare dhe bullgarishtes
- $d = 2,85 U \rightarrow$ midis frëngjishtes dhe oksitanishtes
- $d = 3,6 U \rightarrow$ midis frëngjishtes dhe italishtes
- $d = 4,92 U \rightarrow$ midis romishtes dhe gjuhës hindi
- $d = 29,6 U \rightarrow$ midis romishtes dhe serbokroatishtes

Natyrisht distanca d pasqyron vetëm tiparet leksikore dhe fonologjike, por, në rastin e romishtes, tiparet morfologjike dhe sintaksore nuk luajnë një rol të madh, sepse ato ndryshojnë me pak midis të folmeve sesa tiparet fonologjike dhe leksikore, kurse elementet frazeologjike në këtë punë janë anësore. Prandaj, përveç në një zonë kufitare të diskutueshme (midis $0,95 U$ dhe $1,05 U$), mund të thuhet se kjo metodë jep rezultate të kënaqshme, megjithëse nuk merr parasysh disa elemente jashtëgjuhësore: në disa raste dy të folme që janë nga pikëpamja gjuhësore dialekte të një gjuhe konsiderohen gjuhë të veçanta për arsye historiko-politike: psh. gjuhët skandinave (suedishtja, danishtja e norvegjishtja) janë nga pikëpamja shkencore dialekte të të njëjtës gjuhe. Edhe e kundërta ekziston, si psh. gjermanishtja e Zvicrës e gjermanishtja letrare (pa përmendur bile gjermanishten veriore ose Plattdüütsch) janë gjuhë më vete por trajtohen si dialekte të një gjuhe të njëjtë.

Distanca d mund të llogaritet për çdo çift të folmesh, qoftë dy nga dy, qoftë midis secilës prej tyre me radhë e gjuhës standarde. Në rastin e gjuhës rrome, distanca d midis të folmeve të veçanta të marra dy nga dy luhet nga 0 deri në $0,93 U$ me një frekuencë maksimale midis $0,55$ dhe $0,75$, ndërsa distanca midis të folmeve dhe listës qendrore të referencës (të përbërë nga trajtat më arkaike për çdo fjalë) luhet nga 0 deri në $0,74 U$ me një frekuencë maksimale midis $0,20$ dhe $0,38 U$. Kjo tregon qartë se të folmet rrome janë **dialekte të një gjuhe** e nuk përbëjnë gjuhë të ndryshme. Për t'i pasqyruar në një mënyrë me të dukshme marrëdhëniet midis dialekteve të gjuhës rrome, mund të vizatohen skemat e më poshtme:




Fig. 1




Fig. 2

(BE = Erlides/Bullgari; US = dial. jugor/Rusi; UN = dial. verior/Rusi; PK = kelderash/Poloni; PW = dial. malësor/ Poloni; PN = dial. fushor/Poloni; IS = sinto/Itali; YV = dial. i Borçës/Serbi; YC = dial. i Ublit/Mali i zi; AS = dial. meçkar/Shqipëri; AK = dial. kabuxhi/Shqipëri; YKg = dial. gurbet/Kosovë; YKm = dial. mohaxher/Kosovë; YM = dial. Tophanës/Shkup; YSs = dial. t'hamar i Prokupljes/Serbi; YSn = dial. i Ubit/Serbi)

IV. DIVERGJENCAT MIDIS DIALEKTEVE TË GJUHËS RROME

Përveç disa divergjencave gramatikore (psh. formimi dhe përdorimi i kohëve), diferencat kryesore janë dy llojesh: fonologjike dhe leksikore.

A) DIFERENCAT FONOLOGJIKE; midis tyre mund të dallohen dy nëntipe:

ato *konsekuente* dhe ato *jokonsekuente*:

a) *diferenca konsekuente*: janë ato që përfshijnë tërësinë e gjuhës, si psh.:

- palatalizimi ose jopalatalizimi i shpinoreve para zanoreve të përparme; kështu, nëqoftëse një variant (e folme) i caktuar palatalizon *k*-në para *e*-së dhe *i*-së, ai do të palatalizojë jo vetëm të gjithë *k* në këtë pozicion por edhe në po atë masë edhe *kh*-në si edhe *g*-në po atë pozicion [tip Aa1]:

dialektet «jopalatalizues»	kuptim shqip	dialektet «palatalizues»			
		pak		shumë	
psh. Mohaxher		Topan [Shkup]	Mećkar [Fier]	Arli [Prishtinë]	Kirovë [BS]
kinav	«blej»	ķinav	qinav	çinav	tjinav
kerav	«bëj»	ķerav	qerav	çerav	tjerav
gili	«këngë»	ġili	gjili	xhili	djili
gelo	«iku ai»	ġello	gjello	xhello	djelas
khil	«gjalpë»	ķhill	qhill	çill	t'hjill
khelav	«kërcej»	ķhellav	qhellav	çhellav	t'hjellav

etj...

Shqiptimi këtu jepet me shkronja shqip. Megjithatë, në variantin e Kirovës (dhe të Sllavjanskut) të Bashkimit Sovietik, *tj*, *t'hj* dhe *dj* shqiptohen si dhëmboret e palatalizuara përkatëse në rusishten e shkruhen т, д e тх në punët e rromologëve sovjetikë: тинав, терав, дили, дело, тхил, тхелав si psh. ne Fjalorin rromisht-rusisht të Sergejevskit e Baranikovit, Moskë 1938).

- korrespondenca e [çh]-së e [xh]-së së dialekteve të ashtuquajtur “pa mutacion” (të përhapur sidomos në jug të Ballkanit por edhe në Rusi e në hapësirën karpatike) me [sh']-në e [zh']-në të buta të dialekteve “me mutacion” të Evropës qendrore. Kjo korrespondence paraqitet si një rregull e qendrushme, e cila nuk njeh asnjë përjashtim: të gjitha fjalëve që, në dialektet pa mutacion, shqiptohen me [çh] e [xh], u përgjigjen në dialektet me mutacion, sistematikisht e pa përjashtim, fjalë që shqiptohen me [sh'] e [zh'] të buta përkatësisht, si për shembull [tip Aa2]:

Të folme pa mutacion	Të folme me mutacion	Kuptim shqip
[çhavo]	[sh'avo]	«djalë rrom»
[çhib]	[sh'ib]	«gjuhë»
[xhanav]	[zh'anav]	«unë di»
[gaxhi]	[gaxh'i]	«grua jo-rrome»

Shembull tjetër [tip Aa3]:

Tip «dl/tl»	Tip «gl/kl»	Kuptim shqip
gudli	gugli	«e ëmbël»
phandlo	phanglo	«i mbyllur; i lidhur»

katli	kakli	«bosht (për të tjerrë)»
motlo	moklo	«i cekët, jo i thellë»

b) *diferenca jokonsekuente*: ato shfaqen në një mënyrë të parregullt, të papritur e të paparashikueshme; përfshijnë një numër relativisht të kufizuar fjalësh, sipas dialektit, psh. [tip Ab1]:

Tip A (shumica e të folmeve)	Tip C (mohaxherishtja e Prishtinës)	Tip C (gurbetishtja e Mitrovicës)	Kuptim shqip
šero	šero	šoro	«kokë»
veš	veš	voš	«pyll»
del	dol	dol	«ai jep»
šelo	šelo	šolo	«litar»
por:			
merav	merav	merav	«unë vdes»
morav	morav	morav	«fërkoj»

Përveç kësaj, mjaft të folme paraqesin shqiptimin [ə] (si ë-ja e shqipes) në këtë pozicion: [šəro], [vəš], [dəll], [šəlo] etj.

Korrespondenca [e/o/ə] prek shumë fjalë për arsye se vepron ende në mbaresën e vetës së tretë të së tanishmes të gati të gjitha foljeve veprorë: [-ell/-oll/-əll]. Mirëpo zakonisht diferencat jokonsekuente prekin një numër më të vogël fjalësh, si psh. [tip Ab2]:

Dial. i tipit 1	Dial. i tipit 2	Kuptim shqip
bokh	bukh	«uri»
opre	upre	«lart, sipër»
khosav	khusav	«fshij»
vošt	ušt, vušt	«buzë»
zorali	zurali	«e fortë»
por:		
čorav	čorav	«unë vjedh»
zor	zur	«të holla»
ušti	uști	«çohu!»
ruk h	ruk h	«lis»

Disa të folme kanë bile nganjëherë të dy trajtat krahas njera tjetrës, por vetëm për disa fjalë (psh.: në meçkarishten e Tiranës *opre* kr. *upre* «lart, sipër», por vetëm *bukh* «uri» dhe *kušav* «unë shaj», e jo *bokh* apo *košav*). Mjaft dialekte dallojnë *phovă* «vetulla» e *phuvă* «toka», ndërsa disa të tjera kanë homonimi të të dy fjaleve [tip Ab3].

Dial. i tipit 1	Dial. i tipit 2	Kuptim shqip
čhivav	čhuvav	«vë, vendos» (edhe «hedh»)
živdo [xhivdo]	živdo [xhuvdo]	«i gjallë»
šil [shill]	šul [shull], šël [shëll]	«ftohtë»
sivav	suvav	«unë qep»
siv!	suv!	«qep» (urdhër.)
por:		
sir	sir	«hudhër»

suv	suv	« gjilpërë »
-----	-----	--------------

Kjo korrespondencë përfshin vetëm disa fjalë. Siç duket më sipër, *suv* në mjaft dialekte (tipi 1) shënon «gjilpërë» dhe është në opozicion me *siv* «qep» (urdhërore), ndërsa në disa të tjera (tipi 2) shënon edhe «gjilpërë», edhe urdhëroren «qep», që janë atëherë homonime.

Tjetër shembull [tip Ab4]:

Dial. i tipit 1	Dial. i tipit 2	Kuptim shqip
kìdav	kedav	«unë mbledh»
ginav	genav	«unë numëroj»
por:		
kir(i)	kir(i)	«milingonë»
ger	ger	«qere»

Në një mënyrë të ngjashme, le të përmendim këtu edhe disa sisteme variantesh, që përbëjnë një shteg midis fushës fonologjike e asaj leksikore duke ndërruar psh. numrin e rrokjeve në një fjalë – është rasti i protezës ose aferezës:

- proteza e një *a*-je [tip Ab5]:

mohaxherishtja	meçkarishtja	gurbetishtja	kuptim shqip
amal	mal	amal	«mik»
şunav	şunav	aşunav	«dëgjoj»
biav	biav	abav	«dasmë»
(a)siav	siav	asav	«mulli»
akhor	(a)khor	akhor	«shtet»
akuşav	kuşav	akoşav	«shaj»
naşav	naşav	naşav	«iki»
anav	anav	anav	«sjell, bie»
anav	anav	anav, lav	«emër»

Siç shihet, nuk mund të formulojmë rregulla sinkronike për të parashikuar praninë apo mungesën e *a*-së protetike në çdo fjalë të çdo të folmeje. Gjuha rome ka edhe disa proteza të tilla jokonsekuente, psh. *j* dhe *v* para fjalëve që fillojnë me zanore: *ilo/jilo/vilo* «zemër», *aver/javer/vaver* «tjetër», *udar/vudar* «derë» me një distribucion zakonisht të paparashikueshëm. Disa elemente njihen afër mendsh, si ndikimi i mundshëm i armenishtes (në Azinë e Vogël) për të shpjeguar protezën e *v*-së në fjalët si *udar/vudar* «derë», *ust/vušt* «buzë», *uzo/vužo* «i pastër, i papërzierë», *unzile/vunzile* «borxh», *ov/vov* «ai», *oj/voj* «ajo», *on/von* «ata, ato»; në fakt ose procesi ka vazhduar mbas humbjes së kontakteve me gjuhën armene, ose nuk ka asnjë lidhje me të se e gjejmë me huazime të vonshme si *urma/vurma* «gjurmë» (nga rumunishtja), *unzia/vunzia* «thonj», *ulej/vulej* «vaj» (nga slavishtja) ose *ulica/vulica* «rrugë» (po nga sllavishtja).

- apoteza e nje *k*-je pas fjalëve femërore që shënojnë një send [Ab6]:

të folme pa -k	të folme me -k	kuptim shqip
[çhuri]	[çhurik]	«thikë»
kangli	kanglik	«krehër»
kusti, kušti	kustik, kuştik	«brez»

Si pasojë e ndikimeve midis të folmeve në kontakt, disa dialekte ngatërrojnë trajtat me -k dhe trajtat pa -k.

Ekzistojnë edhe apoteza me -n: [çhurin], etj ...

- mund të përmendim akoma disa korrespondenca që prekin pak fjalë por që janë me përhapje të madhe si psh. me kalimin e mbaresës *-ni* në *-j* të theksuar, me formën e ndërmjetme *-i* të theksuar (duke qenë ajo e fundit e kufizuar tek një numër të vogël të folmesh, si rupanishtja e Shqipërisë ose cerharishtja e Hungarisë) [Ab7]:

Forma origjinale	Forma e ndërmjetme	Forma e shkurtër	kuptim shqip
pani	pai	paj	«ujë»
khoni	khoi	khoj	«dhjamë»
khonālo	khojalo		«i dhjamosur»
kuni	kui (kuptim tjetër)	kuj	«bërryl»
ćeni	(zëvend. nga zlag)	ćej	«ujë»
veni	vei	vej	«rrudhë»
rrani(k)	rrai	rraj	«degë»
xulani	xulai	xulaj	«zonja e shtëpisë»
			«ujë»
po edhe:			
phen	phej	Phej	«ujë»
len	lej	lej	«ujë»
e deri te disa mbiemra (në një numër shumë të vogël të folmesh):			
rromani	rromani	rromani\rromai	«rrome»
gazikani	gazikani	gazikani\gazikai	«jo-rrome»
purani	purani	purani\purai	«e vjetër»

Siç shihet, kufijtë dialektore të korespondencës *-ni/-j* në mbiemrat (rromani/rromai) nuk përputhet me kufijtë e asaj korespondence në emrat (pani/paj).

Hasen edhe raste të tjera alternativësh që përkasin fjalëve të izoluar:

kaxni (meçkarisht) ÷ *khani* (kabuxhisht) ÷ *khajni* (gurbetisht) «pulë fushe»

ćirikli (shumica e të folmeve) ÷ *ćerkli* (Bosnë) «zog»

grast (shumica e të folmeve) ÷ *gras/gra* (gurbetisht) ÷ *graj* (Rusi, Karpate e Sintisht) «kal»

vast (shumica e të folmeve) ÷ *vas/va* (sidomos gurbetisht) «dorë»

kiri (shumica e të folmeve) ÷ *kir* (sidomos gurbetisht) «milingonë»

makhi (shumica e të folmeve) ÷ *makh* (sidomos gurbetisht) «mizë»

guruv (shumica e të folmeve) ÷ *gruv* (meçkarisht) «dem, ka» etj.

Shihet që, megjithë shumëllojshmërinë e trajtave, ato paraqesin një farë koherence.

Më në fund, duhet folur për disa korrespondenca që në paraqitjen e parë duken jokonsekuente por në fakt janë plotësisht sistematike, si psh. [Ab8]:

Të folme të tipit 1	Të folme të tipit 2	Të folme të tipit 3	Kuptim shqip
rovel	rovel	rovel	«qan»
rroj	rroj	roj	«lugë»
rani	rani/raj	rani	«zonjë»
rrani, rranik	rrani/rraj	rani	«degë»
ćoripe	ćoripe	ćoripe	«vjedhje»
ćorripe	ćorripe	ćoripe, ćororipe	«varfëri»
bar	bar	bar	«gardh; bahçe»
barr	barr	bar	«gur»
amaro	amaro	amaro	«yni»
arro	arro, varro	aro, varo	«mjell»
por në një mënyrë më komplekse (<i>sh. më poshtë</i>):			

andro, anro, arno	arro	aro, jaro	«vezë»
mandro, manro, marno	marro	maro	«bukë»
kandro, kanro, karno	karro	karo	«gjemb»
xandro, xanro, xarno	xarro	xaro	«shpatë»
phanr(i)	pharr(i)	phar(i)	«mendafsh»

Tabela tregon se të folmet të tipeve 1 e 2 dallojnë qartë dy «R» të ndryshme, konkretisht një [r] të thjeshtë, i cili shqiptohet si r-ja e thjestë e shqipes e një tjetër, e cila ka disa shqiptime të ndryshme: në asnjë mënyrë nuk mund të ngatërrohet “dega” me “zonjën”, ose “gardhi” me “gurin” apo “vjedhje” me “fukarallëkun” ! Megjithatë, njerëz që nuk dinin mirë romisht, duke qenë se nuk degjionin këtë diferencë shqiptimi, kanë nxjerrë në shekullin 19-të përfundimin nga ngatërresa e vet midis tingujve, edhe në dialektet ku diferencën e dallon veshi rom, që vjedhkan romët mbasi gjuha e tyre nuk dalloka “vjedhjen” nga “varfëria”, prandaj truri i tyre as ai nuk dalloka diferencën e kuptimit !

Kur vazhdojmë analizën, shohim se midis dialekteve që dallojnë [r] nga [rr], ka edhe të tillë që dallojnë më tej midis fjalëve me grupin nr ose ndr, nganjëherë edhe ngr në mes dhe fjalëve ku ky grup thjeshtësohet në [rr] ose biles në [r]. Prandaj, në qoftë se materiali dialektor duket kaotik kur merret globalisht, një analizë sistematike tregon se është shumë koherent e konsekuente.

Mund të themi se jo çdo r-je të dialekteve të tipit 3 i pergjigjet një r e thjeshtë në të folmet e tjerë. Kjo gjendje rrjedh nga humbja e kontrastit origjinal midis r-së e rr-së (siç ndohet edhe në shqipen e Korçës për shembull – një dukuri kjo që quhet «neutralizim»). Rjedhimisht identifikohet rr-ja me r- në me një shqiptim unik [r], kurse të folmet e tjera ruajnë sistemin origjinal, i cili është me i begatë me opozicion të gjallë midis fonemave /r/ dhe /rr/.

Një gjendje e krahasueshme vërehet në shumë dialekte që kanë humbur opozicionin midis [h]-së (faringale) dhe [x]-së (velare si *ach-Lauti* i gjermanishtes).

Le të shënojmë se, në shumicën e rasteve, diferencat jokonsekuente janë mbeturina të diferencave konsekuente të dikurshme, për të cilat tani për tani nuk shfaqet më kjo konsekuente në sinkroni, se rregulla nuk vepron më dhe shumë elemente të reja kanë depertuar në gjuhë; ato fshehin konsekuencën e dikurshme.

Perveç varianteve konsekuente dhe jokonsekuente, ekzistojnë në romishten variante të lira. Shembulli më karakteristik është ai i mbaresave $-pa = -ba = -pe = -be = -pen = -ben = -mo = -mos$ (shumës *-màta*). Në çdo të folme bashkekzistojnë disa prej këtyre trajtave; ato shkëmbehen në përgjithësi pa diferencë apo ngjyrim kuptimor apo stilistik. psh. *meripe = meriba = merimos = meripen* etj ... “vdekje”.

Një shembull paraqet një interes të veçantë [Ab9]:

Dial. i tipit O	Dial. i tipit E	Kuptim shqip
Phirdom, -um	phirdem	«eca»
Dikhlom. -um	dikhlem	«pashë»
Xalom, -um	xalem	«hëngra»
Pilom, -um	pilem	«piva»
som, hom, sinom, hium, sinum, sium...	sem	«jam»
por:		
rrom	rrom	«rrom, burrë»
them	them	«shtet»
shih edhe:		
mukhav	mekav, mekhav	«lë, braktis»
si edhe nyjen shquese në shumës:		
o Rroma	(l)e Rrom(a)	«Rromët»

o phrala	(l)e phral(a)	«vëllezërit»
o phenã	(l)e pheja	«motrat»

Edhe këtu në pamjen e parë, na duket sikur jemi në të njëjtën situatë si më përpara, me korespondencë jokonsekuente. Megjithatë, nëqoftë se marrim parasysh edhe morfologjinë, shohim se alternanca [o / e] shfaqet vetëm në dy raste:

- mbaresa e vetës së parë së foljeve në të kaluarën e thjeshtë
- mbaresa e vetës së parë së kopulës «jam» në të tanishmën,

kurse në të gjithë rastet e tjera nuk ka asnjë alternancë – përveç një lekseme foljore, e cila paraqet një shpërndarje dialektore të ngjashme me atë të mbaresës *-om/-em* (sh. më lart): *mukhav = mekav* «lë, braktis, lejoj» (shih tabelën, linja e fundit) si edhe forma e nyjës shquese së shumësit. Thuhet se ky sistem përbën një shteg midis fushës fonologjike e asaj morfologjike.

B) DIFERENCA LEKSIKORE: ato janë tre llojesh.

a) diferenca që rrjedhin nga zgjedhje të ndryshme në fondin e përbashkët leksikor, psh. [Ba1]:

Disa të folme	Disa të tjera	Kuptim shqip
zukul	rikono	«qen»
nakh	ruthuni	«hundë»
ilo	rroj	«zemër»
gilavel	gilabarel, bagal	«këndon»
phuv	pošik	«dhe, tokë»
sung	khand	«erë, aromë»

Tabela e mësipërme tregon situatën faktike sot, por në fakt të dy serësh fjalësh kanë bashkekzistuar në romisht e mjaft të folme ende i kanë mbajtur të dy, por me diferencë kuptimore:

zukul «qen», por *rikono* «këlysh»

nakh «qen», por *ruthuni* «turi»

ilo «zemër», por *rroj* «pleksus»

phuv «dhe, tokë», por *pošik* «pluhur»

sung «erë e mirë», por *khand* «erë e keqe»

Vetëm *gilabel*, me variantin *gilabarel*, e *bagal* nuk dallohen semantikisht por vetëm gjeografikisht.

Me kalimin e kohës, folësit e kanë thjeshtësuar vend e vend gjuhën duke humbur nuancat kuptimore e fjalët që i shprehin.

b) diferenca që rrjedhin nga humbja (harresa), në një ose në disa të folme, e fjalëve tashmë të zëvendësuara prej huazimesh [Bb1]:

Fjala origjinale rrome	Huazim lokal	Vendi i përdorimit	Kuptim shqip
amal	prietëno	Rumani (prietën)	«mik»
ilo	zëmra	Shqipëri (zemër)	«zemër»
patrin	lístos	Slllovakí (list)	«gjethe»
luludi	rùža	Bosnjë (ruža)	«lule»
	kfiàtos	Poloni (kwiat)	
zukul	ćèri	Rumani (cer)	«qiell»

Nganjëherë fjala origjinale ruhet akoma përbri huazimit, si *vilò* në meçkarisht, krahas *zemra*, që përdoret sidoqoftë më shumë.

Në disa raste, përhapja e fjalës origjinale kufizohet te një numër i vogël dialektesh, kurse huazimi praktikohet gjerësisht, psh. fjalet rome:

fjala rome e mirëfilltë	huazime	vend
<i>rig</i> «anë»	<i>stràna</i> <i>jàna</i> <i>pàrtea</i> <i>storòna</i>	Jugosllavi, Bullgari Shqipëri Rumani BS
<i>deräv</i> «det» (nga persishtja dariā)	<i>mòre, denìzi, dèti</i> <i>denìzi, dèti</i> <i>mària</i> <i>mòrjo</i> <i>mòros, mòzos</i> (edhe <i>baro pani</i> «uji i madh»)	Jugosllavi, Bullgari Shqipëri Rumani BS Poloni (vende të ndryshme)
<i>phurt</i> «urë»	<i>mòsto</i> <i>pòdo</i>	në shumë vende sllave Rumani, Hungari

c) diferenca që rrjedhin nga huazime prej gjuhësh të ndryshme, që janë bërë për të shprehur nocione të reja [Bc1]:

«lokali i milicisë»: *SUP* (Jug. < Секретаријат Унутрашњих Послова), *rajòni* (Shq.), *rendòsègo(s)* (Hung.), *komisariàtos* ose *pùduo* (Pol.), etj ...

«orë»: *sahàti* (Jug. Shq.), *òra* (Shq. Hung.), *stùnda* (Pol. Nga gjermanishtja), etj ... Ekzistojnë edhe krijime të brendshme, si zhargon: *mardo* (BS).

«spital»: *bòlnica* (Jug.), *spitála* (Shq.), *spitàlos* (pol.), etj ...

«kooperativë»: *zàdruga* (Jug.), *koperàcia* (Bullg.), *spudièlnja* (Pol.), etj ...

Në disa raste, nocioni nuk është i ri, mund të jetë konkret dhe i thjeshtë, dhe si duket fjala për ta shprehur dikur ka ekzistuar, por sot për ndonjë arsye të panjohur, ka humbur, si psh.: .

«akull»: *lèdo* (Jug.), *lòdo* (Bol.), *lègos* (Hung.), *pàho*, me variantin *phao* (ne disa vende, nga greqishtja), etj ...

«martoj»: *ansuriv* (Rum.), *zèlinav* (Jug.), *prandenav* (Bullg.), etj ...

«rrënjë»: *kjòki* (Bullg. nga turqishtja), *rènja* (Shq.) *korèno* (Jug.), *korènjo* (BS), *zìla* ose *zèla* (ne vende të ndryshme si duket nga sllavishtja) etj ... Fjala origjinale mund të ketë qenë *darrin*, e njohur në Shkup, ose *drab*, por kjo e fundit sot është më e përdorur me kuptim «ilaç».

Diferenca leksikore pasqyrohen në përpjesëtimin e shifrave që tregojnë bashkësinë midis të folmeve në bazë të fjalëve të listës prej 200 nocionesh. Ato shifra, të mbledhura në më shumë se 30 çifte dialektesh paraqiten me vlerat si më poshtë – nga përputhja e plotë e deri te mospërputhja midis fjalëve (jepen për çdo nivel ngjashmërie [nga 4 deri në 1], minimumi i konstatuar si përqindje e rasteve me përputhje të nivelit respektiv, pastaj maksimumi i konstatuar i përqindjes e më në fund mesatarja e përqindjes në fjalë):

- ngjashmëri e plotë:
 - 4 pika ~ nga 50% deri në 85%; mesatarisht 70%;
- ngjashmëri e pjesshme:
 - 3 pika ~ nga 10% deri në 27%; mesatarisht 15%;
 - 2 pika ~ nga 1% deri ne 7%; mesatarisht 4%;
 - 1 pikë ~ nga 0% deri ne 4%; mesatarisht 2%;
- fjalë pa lidhje të dukshme:
 - 0 pikë ~ nga 0% deri në 20%; mesatarish 12%.

Në balancimin e koeficienteve, një peshë të ndryshme kanë huazimet: afro 17%, prej të cilave afro 7% janë të vjetra dhe të përbashkëta (sidomos numërorët 7, 8 e 9 dhe fjalët si psh. kòkalo «kockë», nga greqishtja ose bullgarishtja, *morthi* «lëkurë» nga amenishtja, etj...). Pjesa e huazimeve që ndryshojnë

ndër dialektet përbën rreth 10% të listës. Nëse llogaria e distancës kryhet edhe një herë pa marrë parasysh ata huazime e duke u mbështetur vetëm në elementet e tjera, atëherë del një distancë d' më e shkurtër sesa kur llogaritet në bazë të listës së plotë.

Kemi në këtë mënyrë një tregues të korigjuar T' dhe një distance të korigjuar d' :

	BE	US	UN	PK	PW	PN	IS	YV
T	92,53	88,0	87,1	86,3	87,90	81,15	75,9	84,85
d	0,19	0,32	0,35	0,37	0,32	0,54	0,74	0,42
T'	95,9	93,33	93,17	93,86	95,52	88,22	83	90,84
d'	0,1	0,14	0,14	0,15	0,11	0,31	0,48	0,17

	YC	AS	AK	YKg	YKm	YM	YSa	YSn
T	91,05	87,63	95,05	86,25	87,62	87,25	86,54	87,10
d	0,23	0,33	0,12	0,38	0,33	0,34	0,36	0,35
T'	95,98	94,44	98,04	93,24	94,00	96,4	93,75	91,0
d'	0,1	0,14	0,05	0,17	0,15	0,09	0,15	0,24

Tabela e mësipërme pasqyron distancat midis listës standarde e listave të përkthyer në ato 18 të folme të përdorura në fillim të artikullit për të përcaktuar nivelin e divergjimit të të folmeve romë nga lista qendrore e referencës. Kjo mund të shprehet edhe nëpërmjet skemës më poshtë:




Fig. 3

(BE = Erlides/Bullgari; US = dial. jugor/Rusi; UN = dial. verior/Rusi; PK = kelderash/Poloni; PW = dial. malësor/ Poloni; PN = dial. fushor/Poloni; IS = sinto/Itali; YV = dial. i Borçës/Serbi; YC = dial. i Ublit/Mali i zi; AS = dial. meçkar/Shqipëri; AK = dial. kabuxhi/Shqipëri; YKg = dial. gurbet/Kosovë; YKm = dial. mohaxher/Kosovë; YM = dial. Tophanës/Shkup; YSs = dial. t'hamar i Prokupljes/Serbi; YSn = dial. i Ubit/Serbi)

Më në fund, në qoftë se huazimet, në vend që të lihen mënjane në këtë llogari, zëvendësohen me fjalë të zgjedhura nga një komision gjuhësor, në mënyrë që të jenë të përbashkëta për të gjitha të folmet, natyrisht distanca që do të dalë atëherë si e "korigjuar" do të jetë akoma më e shkurtër, gjë që do të tregojë se gjuha do të jetë ende më e unifikuar.

V. KUPTIMI I «STANDARDIT» NË GJUHËN QENDRORE RROME

Siç e kemi parë më lart, analiza dialektometrike e romishtes vë në pah homogjenezitetin që ajo tregon ndër dialektet e saj. Kjo është baza e pamohueshme shkencore nga niset procesi i krijimit të trajtës së përbashkët të kësaj gjuhe. Në botën e sotme, shumë gjuhë janë duke kërkuar trajtën e tyre letrare; në këtë fushë, nuk predominon më praktika e zgjedhjes së një dialekti të posaçëm, që të ngrihet në rolin e gjuhës letrare, siç është praktikuar dikur, sidomos në sh. XVII e XVIII. Edhe romët, në Kongresin e parë rom në Londër, në vitin 1971 nën presidencën e poetit rom jugosllav të shquar Slobodan Berberski, kanë hedhur poshtë këtë opsion, duke shpallur:

«Nane jekh dialekt po lacho avere dialektonenθar, ama mangas [të ovel amen] jekh çhib maşkarutni (sentràlno) normalizime të vakeras an-o kongresa thaj të lekhas (pişas) an-o inter-nasionàlo lila»

«Nuk ka një dialekt më të mirë sesa dialektet e tjera, por kerkojmë [të kemi] një gjuhë të përbashkët (qendrore) të normalizuar që të flasim në kongreset dhe të shkruajmë në fletët ndërkombëtare»

(Komisia e çhibaqi – Rromano Kongrèso, London 8-12 IV 1971)

Meqë elementi i përbashkët tregohet mjaft i begatë, kjo gjuhë «qendrore» duhet të mbështetet sa më shumë në këtë element të natyrshëm. Në këtë mënyrë ajo do të jetë me të vërtetë e përbashkët (bile më shumë sesa një dialekt i veçantë i zgjedhur për arsye jogjuhësore, për arsye prestigji në një fushë të caktuar për shembull) dhe nuk do të dallohet shumë nga secili dialekt në veçanti.

Në këtë etapë shtrohet pyetja: cili do të jetë roli i dialekteve të ndryshme në themelimin e gjuhës së përbashkët? Ky rol lidhet drejtpërdrejt me pozicionin e tyre ndaj pikës qendrore, në kuptim dialektometrik; natyrisht të folmet që janë tepër larg nga tërësia e sistemit të trajtave të përbashkëta, si *paggerdi chib* (anglo-romani) ose *çipi kali* (ibero-romani) nuk mund të marrin pjesë në mënyrë vendimtare në themelimin e gjuhës së përbashkët. Në fakt është vështirë të propozohet rreptësisht një kufizim i dialekteve që do të futen në këtë punë (që të mos preken ndjenjat e folësve), por mund të thuhet që më të përshtatshme janë ato të folme që mbajnë një distancë *d'* prej më pak sesa 1 U midis tyre, d. m. th. që kanë një *d'* prej më pak sesa 0,5 U nga pika qendrore. Konstatohet që faktikisht gati të gjithë dialektet e Evropës lindore dhe të Ballkanit qëndrojnë në një distancë prej më pak sesa 0,5 U nga pika qendrore (lista qendrore e referencës). Rasti i dialekteve *manouche* e *sinto* është i veçantë: megjithëse *d'*-ja e tyre (distanca e korigjuar nga pika qendrore) është prej afro 0,5 U në bazë të leksikut e të fonologjisë, nga pikëpamja gramatikore këto dialekte dallohen shumë nga dialektet e tjera, të cilët janë shumë homogjenë nga pikëpamja e strukturës gramatikore. Përkundrazi, konstatojmë divergjenca të theksuara midis strukturës së përbashkët të këtyre të fundit dhe asaj së dialekteve *manouche* e *sinto*, gjë që sjell natyrisht me vete shumë pengesa në nivelin e ndërkuptimit midis folësve, qoftë gojarisht, qoftë me shkrim. Megjithatë, mund të ndodhë rasti që ato të kenë ruajtur ndonjë fjalë të fondit të lashtë, të cilën e kanë humbur dialektet e tjera. Atëherë të folmet *manouche* e *sinto* mund ta japin këtë fjalë për pasurimin e gjuhës së përbashkët. Më vonë, fjala përkatëse mund të gjendet edhe në ndonjë të folme rrome gjatë studimit të mëtejshëm të dialekteve – dhe kjo ka ndodhur mjaft shpesh: ka qenë për shembull rasti i fjalës me kuptim «gjë, -ra». Shumica e të folmeve rrome përdorin në këtë kuptim një fjalë me kuptim «diçka», të trashëguar: *khanć*, të huazuar: *çipota* ose të përbërë: *vareso*. Fjala me kuptimin «gjë» njihet në fillim të kërkimeve vetëm në anglo-romani: *chomoni* dhe në *sinto* *ćomuni*, deri kur u has në të folmet e Shqipërisë së Mesme nën trajtën origjinale: *ćumuni*.

Nga ana e tyre, *Manouchët* e *Sintot* mund qoftë të krijojnë gjuhën e vet letrare, përkatësisht *manushishten* dhe «*sintishten*», qoftë të pranojnë gjuhën rrome të përbashkët apo qendrore si mjet komunikimi me rromët e tjerë. Fatkeqësisht, harresa e plotë e gjuhës amtare është prirja kryesore sot në këtë grup, për shkak të mungesës së bashkëfolësve potencialë.

Më tej shtrohet një pyetje tjetër: a duhet rekomanduar që të ketë gjuha rrome vetëm një trajtë të ngurtë unike, apo është e preferueshme që të bashkekzistojnë disa variante? Në rastin e dytë, deri ku mund të jetë elastike norma dhe variantshmëria e saj?

Vlen të kujtohet këtu se edhe gjuhët e njësuara prej kohësh në teori, si. psh. frëngjishtja ose anglishtja, pësojnë, jo vetëm në ligjërimin popullor por edhe në përdorimin zyrtar (shtyp, radio-televizion, etj ...) një numër jo të vogël shmangiesh që nganjëherë errësojnë ndërkuptimin ose e pengojnë atë. Mund të thuhet se janë në ridialektalizim e sipër, zakonisht jo mbi një bazë gjeografike, siç ishte më parë (faktor që prapëseprapë nuk lihet mbas dore kur e njëjta gjuhë flitet në disa shtete të ndryshme), por sidomos shoqërore, klasore, mjedisore, etj ... Ky është një proces i natyrshëm dhe gjuha s'pushon së kërkuari pikën e saj të ekuilibrit midis konvergjitimit e divergjitimit.

Këtë, gjuhëtarët² tashmë e dinë dhe kanë hequr dorë prej kohësh nga një model i ngurosur i standardit të gjuhës, ndoshta ideal në teori por i paarrtshëm në praktikë. Ata preferojnë t'i shfrytëzojnë prirjet e rrymat e zhvillimit për të ruajtur ekuilibrin natyror të gjuhës, si kapiteni që përpiket të kombinojë skuqet e erërat që anija të qëndrojë në vend. Siç dihet, një ndër të parët që pranuan shumëtrajtësinë e gjuhës letrare qe Vuk S. Karaxhiçi. Në sajë të vizionit të tij, deri më sot gjuha serbokroate përdoret zyrtarisht në disa trajta të afërta por të ndryshme në nivelin e RSFJ-së, gjë kjo që u zyrtarizua nga ngritja e një komisioni të posaçëm, të cilit i është besuar hartimi i korpusit ligjor të Federatës në tre variantet referenciale në hapësirën e të foljmeve serbe e kroate, përkatësisht: në serbokroatishten e R-ve SF të Serbisë e Malit të Zi, në kroatishten letrare të RSF-së së Kroacisë dhe në serbokroatishten ose kroatoserbishten me shqiptim ijekavian të RSF-së së Bosnjës e Hercegovinës. Mbi këtë model, edhe rromishtja mund të pranojë fare mirë disa trajta mjaft të afërta që folësit të kuptohen njëri tjetrin por distinkte, të cilat eventualisht mund do të zhvillohen më vonë drejt një trajte unike, çka është e mundur por jo e domosdoshme.

Gjuha qëndrore ose letrare duhet të plotësojë dy kërkesa themelore:

- të lehtësojë sa më shumë komunikimin e ndërprerimin midis të gjithë rromëve;
- të jetë sa më afër dialekteve të natyrshe, për të mënjeluar përhapjen e një gjuhe letrare artificiale. Çdo variant që plotëson këto dy kërkesa mund të konsiderohet si pjesë përbërëse e gjuhës letrare, qëndrore ose të përbashkët.

Si pasojë, diferencat midis varianteve do të jenë më të vogla sesa diferencat midis dialekteve në gjendjen e natyrshe, por klasifikimi i tyre është i ngjashëm.

VI. TRAJTIMI I DIFERENCAVE TË NDRYSHME

A) TRAJTIMI I DIFERENCAVE FONOLOGJIKE, të cilat, si më lart, ndahen në:

a) *diferenca konsekuente*: një nga parimet e rromishtes së përbashkët është që të respektojë me sa më shumë besnikëri autenticitetin e dialekteve dhe t'i afrojë ato njëkohësisht midis tyre. Kjo detyrë i është besuar «shkrimit të mesëm», i cili mbështetet në parimin e mëposhtëm:

shkrimi shënon me një shkronjë të përbashkët disa realizime të ndryshme që janë në korrespondencë konsekuente.

- Është psh. korrespondenca midis shpinoreve të mirëfillta ([k], [kh] e [g]) dhe varianteve të tyre pak a shumë të palatalizuara para zanoreve të përparme (shih më lart shembuj të dhënë në disa të folme te tabloja IV.Aa).

Shkrimi i përbashkët do të jetë në këtë rast *k*, *kh* e *g*, mbasi mjafton të pajisim dialektet jopalatalizuese më këtë rregull leximi:

«shpinoret *k*, *kh* e *g* lexohen [k], [kh] e [g] në çdo pozicion»,

ndërsa dialektet palatalizuese i pajisim me këtë rregull leximi:

«shpinoret *k*, *kh* e *g* lexohen si [k], [kh] e [g] para zanorëve jo të përparme (d. m. th. të prapmeve *u*, *o* dhe të mesmes *a*) dhe lexohen të palatalizuara para zanorëve të përparme, d.m.th. përkatësisht *k* si [k], [q], [ç] ose [tj], *kh* si [kh], [qh], [çh] ose [thj] dhe *g* si [g], [gj], [xh] ose [dj]».

- Për korrespondencat [çh / sh'] dhe [xh / zh'] është akoma më e thjeshtë: për shkronjën e përbashkët *çh*, dialektet pa mutacion njohin vetëm shqiptimin [çh] dhe për shkronjën *z* vetëm

² Që në vitin 1920, André Meillet [Andre Meje] konstatonte, mbi shembullin grek, se gjuha e përbashkët »nuk është një gjuhë e ngurosur, po nuk është gjithashtu një gjuhë me një zhvillim të rregullt; ajo ndjek njëfarë ekuilibri që vazhdimisht luhetet midis qendrimit e zhvillimit« (in Historia e Greqishtes). Vendri në »Ligjërim« (Paris 1914-24, 39) thekson rolin e shkrimit në mirëmbajtjen e gjuhëve të përbashkëta (f. 320).

shqiptimin [xh], kurse dialektet me mutacion njohin respektivisht vetëm shqiptimet [sh'] dhe [zh'] të buta për ato dy shkronja të përbashkëta.

Disa diferenca nga ato konsekuente janë tepër të kufizuara (si psh. shqiptimi i *kh*-së si [tsh] ose [ts] dhe shqiptimi i *k*-së si [ts] para *e*-së në dialektin rrom të Kurskut në Rusinë jugore dhe prandaj shtohet pyetja a duhet pranuar apo jo në gjuhën letrare. Ndoshta, më e pranueshme do të ishte që Rromët nga Kursku të heqin dorë nga kjo karakteristikë shqiptimore e dialektit të tyre në situatën e komunikimit ndërkombëtar dhe të përpiqen atëherë të shqiptojnë si të tjerët, sesa të krijohet enkas një rregull leximi për ta. Zhdukja e këtij tipari dialektor të vogël nuk shkakton ndonjë humbje kulturale të ndjeshme.

Rrjedhimish mund të nxjerrim rregullën: diferencat shqiptimore gjerësisht të përhapura dhe konsekuente **nuk pasqyrohen në shkrim**, i cili është unifikuar, por vetëm në lexim, kurse në lexim secili shqipton sipas veçorive të dialektit të saj/tij. Me krijimin e një shkrimi në mënyrë që të jetë i përbashkët duke respektuar njëkohësisht veçoritë e varianteve dialektore të ndryshme, e rrjedhimisht edhe ndjenjat e folësve ndaj së folmes së vet, themelohet një sistem i cili nga një anë lehtëson komunikimin e gjerë midis Rromëve e nga ana tjetër nuk cënon integritetin e trashëgiminë gjuhësore të tyre.

Ky proces quhet **kodifikim**, d. m. th. **adaptimi ndaj gjuhës i një kodi grafik** (ose sistemi shkronjash) i cili jep në shkrim mesazhin që folësi i beson sipërfaqes materiale (letër, gur, ekran ose tjetër) ku ka vendosur ta shkruajë.

b) *diferenca jokonsekuente*: ndër këto diferenca duhen dalluar ato që janë shumë të përhapura (si korrespondenca *e/o* në shembullin më lart [Ab9]) dhe ato që njihen vetëm në një grup të vogël të folmesh, ose që prekin një numër të vogël fjalësh, edhe pse mund të jenë gjeografikisht mjaft të përhapura (si korrespondenca *u/i* në shembullin më lart [Ab3]).

Për këto diferenca, në një farë mase mund të zbatohet *kodifikimi* kur ato janë të përhapura dhe përfshijnë një numër të konsiderueshëm fjalësh: një shkronjë do të shënojë atëherë dy a më shumë realizime të ndryshme, por mbasi diferencat nuk janë konsekuente, një shënjë diakritike është e domosdoshme për të treguar ku vepron rregulla e veçantë e leximit e ku nuk vepron.

Psh. në rastin e korrespondencës së sipërpërmendur *e/o* [Ab1] (por jo [Ab9] – e cila nuk ka lidhje me të) mund të shënojmë veçorinë dialektore në fjalë me anë të shkronjës *ë* kur janë të dy realizimet në korrespondencë [Ab1']:

Tip A (shumica e të folmeve)	Tip C (mohaxherishtja)	Tip C (gurbetishtja)	Kuptim shqip
šero	šero [šero]	šëro [šoro]	«kokë»
veš	veš [veš]	vësh [voš]	«pyll»
del	dël [dol]	dël [dol]	«ai jep»
šelo	šelo [šelo]	šëlo [šolo]	«litar»
por:			
merav	merav [merav]	merav [merav]	«unë vdes»
morav	morav [morav]	morav [morav]	«fërkoj»
merel	merël [merol]	merël [merol]	«ai vdes»
morel	morël [morol]	morël [merol]	«ai fërkon»

Perveç kësaj ekzistojnë një numër dialektesh ku shqiptimi është ai i *ë*-së së shqipes. Zgjedhja e shkronjës *e* si bazë mbështetet në arsye diakronike: trajtat me [o] rrjedhin nga trajtat me [e] e jo anasjelltas.

Korrespondenca [e / o / ë] prek një numër të madh fjalësh. Ka edhe disa korrespondenca që përfshijnë vetëm disa njësi leksikore, si psh. korrespondenca [u / o] ose korrespondenca [u / i] të sipërpërmendura, ose bile vetëm një fjalë. Në raste të tilla, krijimi i një rregulle leximi vetëm për disa fjalë nuk ka leverdi dhe preferohet atëherë që të pranohen të dy trajtat në prani si psh. *bokh*

krahas *bukh*, ose *zivdo* krahas *zuvdo*, për arsye se bashkekzistenca e të dy varianteve nuk rëndon ndërkuptimin; kur ka më shumë se dy variante (psh. folja «mbaj»), bëhen përpjekje për të zgjedhur vetëm dy ose tre trajta mjaft reprezentative, që do të pranohen si variante të gjuhës së përbashkët. Eliminimi i trajtave tepër periferike nuk paraqet për gjuhën një humbje të rëndësishme, kurse është një fitim i dukshëm për ndërkuptimin. Zgjedhjen e trajtave variantore të pranueshme në gjuhën e përbashkët e quajmë **normalizim**, d. m. th. **adaptimi i gjuhës ndaj një sistemi normash**, dhe hyn në veprim vetëm kur kodifikimi nuk mjafton për të siguruar një ndërkuptim të kënaqshëm e të lehtë midis folësve me origjina dialektore të ndryshme.

B) **TRAJTIMI I DIFERENCAVE LEKSIKORE**: pavarësisht nga shkaku i divergjencës, kjo nuk rregullohet dot me anë të kodifikimit, siç e kemi përcaktuar më lart, por me anë të normalizimit. Ky proces do të paraqitet në mënyrë të hollësishme në pjesën e dytë të këtij artikulli, por mund të thuhet që tani se normalizimi eliminon huazimet e padëshirueshme, përhap leksemat rome, plotëson boshllëqet e fjalorit, mënjanon trajtat rome tepër periferike dhe kështu ndihmon për pastrimin e unifikimit të gjuhës.

Shkurtimeisht, mund të themi se, në procesin e unifikimit të gjuhës, veprohet në dy etapa:

- 1) me anë të **KODIFIKIMIT**, zgjerohet sa më shumë baza e shkruar e përbashkët e të folmeve
- 2) me anë të **NORMALIZIMIT**, zgjidhen trajtat variantore të pranueshme dhe eliminohen elementet që kodifikimi nuk ka bashkuar dot në një masë të kënaqshme dhe të cilat krijojnë vështirësi për ndërkuptimin (sidomos trajtat tepër periferike dhe huazimet).

VII. PREFERENCA NË TRAJTIMIN E DIFERENCAVE TË NDRYSHME

Megjithëse shkrimi është përpunuar për të transkriptuar një llojshmëri të gjerë trajtash, disa elemente nuk mund të reduktohen në një trajtë të përbashkët e atëherë shfaqet një problem në komunikim, në qoftë se folësit hasin vështirësi në kuptimin me njëri tjetrin. Në këto raste, siç e kemi parë më lart, hyn në veprim normalizimi, duke ndjekur një shkallëzim preferencash midis trajtave të ndryshme. Parimi është që ato trajta shumë atipike e që rrjedhimisht pengojnë ndërkuptimin pa mbartur një vlerë kulturore të dukshme, të përdoren vetëm në raste domosdoshmërie stilistike. Natyrisht, liria e zgjedhjes është shumë më e gjerë në tekstet me ngjyrim emocional të fortë, siç janë poezia dhe teatri, sesa në lajmet radiofonike ose në tekste shkencore.

Ato preferenca janë katër nivelesh:

A) **Fonetike**. Parimi kryesor është se preferohet çdo shqiptim që dallon mirë trajtat e ndryshme përkundrejt atyreve që i neutralizojnë, d. m. th. parësia i jepet qartësisë dhe kuptueshmërisë.

Psh, siç kemi parë më lart, disa dialekte palatalizojnë disa pak a disa shumë shpinoret *k*, *kh* e *g* para zanorëve të përparme (*e* dhe *i*). Në ligjërimin e kujdesshëm, rekomandohet që ky palatalizim të mos arrijë deri te asgjësimi (i quajtur në gjuhësi “neutralizim”) i opozicioneve $k \neq \acute{c}$, $kh \neq \acute{c}h$ dhe $g \neq \acute{z}$. Me një fjalë, mirë është që të dallohet *k* e palatalizuar qoftë më pak a qoftë më shumë ([k'] [q]) si në *kinav* ([kinav, k'inav, qinav]) «blej» nga *ć*-ja e vërtetë ([ç]) si në *ćik* «baltë», *ćirikli* «zog», etj ... Po ashtu edhe me *kh* e *g*: psh. *khindo* «i lodhur» mund të shqiptohet më pak ose më shumë i palatalizuar ([khindo, k'hindo, qhindo]) por pa arritur deri neutralizimi i opozicioni $\acute{c}h \neq kh$ [qh me palatalizim], në mënyrë që të mos ngatërrohet ajo fjalë me *ćhindo* ([çhindo]) «i prerë». Gjithashtu në Rumani, palatalizimi i *g*-së në *gili* «këngë» arrin në disa fshatra që të çojë deri te ngatërresa e asaj fjale *gili* me fjalën tjetër *dili* (e cila fillon me “d”, gjithashtu të palatalizuar para *i*-së) «e marrë, e çmendur».

Le të japim një shembull tjetër: neutralizimi i fonemave *h* dhe *x* me një realizim të përbashkët si [h] tolerohet, por më e rekomandueshme është që të dallohen në shqiptim mbasi ka disa raste ku ato dallojnë dy fjalë nga ana kuptimore, psh. *xera* «gomerë» nga *hera* «1. rrëzët e kofshëve; 2. zgavrat e gjunjëve (mbrapa)». Gjithashtu, siç është theksua më lart [Ab8], mjaft dialekte kanë humbur opozicionin midis *r*-së (si [r] -ja e shqipes) e *rr*-së (që mund të shqiptohet në mënyrë të ndryshme. Mirëpo rekomandohet që ky opozicion të ruhet e të kultivohet në gjuhën e përbashkët.

Shqiptimi i fonemave *çh* ([çh]) dhe *z* ([xh]) respektivisht si [sh'] dhe [zh'] në një sërë dialektesh të Evropës qendrore, të quatur “me mutacion” [Aa2], pranohet fare mirë në gjuhën e përbashkët rrome. Në gojën e popullit, realizimi i këtyre fërkimoreve të buta nuk përputhet me shqiptimin e fërkimoreve *ś* [sh] dhe *ź* [zh]. Megjithatë personat që romishten e kanë mësuar nga librat e shkruar nga jo-romë (të cilët zakonisht nuk dallojnë mirë tingujtë e gjuhës rrome dhe shkruajnë njësoj në alfabetin e gjuhës jo-rome të vendit *çh* [sh'] e *ś* [sh] ose *z* [zh'] e *ź* [zh]) nuk dinë që shqiptojnë mirë romishten dhe, deri sa janë të impenjuar në politikë, ekziston rrezik të imitohen, për arsye prestigji, nga Rromët që gjithmonë i kanë dalluar tingujt respektivë e kanë mbajtur për shekuj një shqiptim korrekt.

Edhe gjuhët e tjera njohin prirjen e neutralizimit të dallimeve kuptimore. Psh. si shqipja popullore e veriut po ashtu edhe serbishtja e Kosovës nuk dallojnë më *ç* e *q* (serbisht *ч* e *ћ*) ose *xh* e *gj* (serbisht *μ* e *ћ*) e ngatërrojnë *çaj* e *qaj*, ose serbisht *печу* «fjalët» e *пећу* «për të thënë». Megjithatë, asnjë gramatikë, asnjë rrymë, asnjë shkollë nuk inkurajon të “thjeshtësohet” gjuha duke imponuar barbarizma si “pse po çan kaç shumë ?” ose në serbisht *хочу вам речи* “dua t’ju them”. Kështu nuk mund të veprojë asnjëri, përveç atyre që dinë romisht vetëm përciptazi ose natyrisht atyre që synojnë ta shkatërrojnë romishten sepse nuk e ndiejnë atë as si gjuhë e vërtetë, as si gjuhë e tyre amtare.

B) **Morfologjike.** Edhe këtu vepron parimi i preferencës për trajtat që nuk pengojnë kuptimin dhe nuk krijojnë moskonsekuencë në sistemin e rregullave të leximit.

Psh. midis shumësave ekzistuese *brègură* dhe *brègă* të fjalës *brègo* «mal, kodër», ndoshta do të ishte e udhës që të preferohet *brègură* për arsye se në shumë dialekte, *g*-ja palatalizohet para zanoreve të parajotizuara (*ă* [ja], *û* [ju], etj.) në fjalët me prejardhje indiane. Kjo dukuri vërtet nuk shfaqet në trajtën *brègă* mbasi kjo fjalë hyri në gjuhën rrome vonë, mbas periudhës së veprimit të këtij palatalizimi; megjithatë, për të mënjeluar leximin e gabuar (të tipit [*bregja] ose [*brexha]) ose krijimin e një rregulle shkrimi të posaçme (të tipit *brèg'ă*, *brèg-ă* ose *brèg-ă*) apo leximi më përjashtime, mund të këshillohet preferenca për trajtën *brègură*, e cila që nuk paraqet problemin e palatalizimit.

Gjithashtu për arsye qartësie, nuk rekomendohen trajtat me *asimilimin e grupeve nd > n, ng > η* ose *mb > m*, siç ndodh në disa të folme nën ndikimin e gegërishtes. Në fakt, këto të folme nuk asimilojnë grupet në fjalë brendapërbrenda rrënjës (*vando* «vezë» mbetet me *nd*), por i asimilojnë të kufiri ndërmorfemik: [shuna] për *śunda* «dëgjoj» (rrënja *śun-* + prapashtesa e së kaluarës *-da*) ose [amena] për *amenθa(r)* «prej nesh» (përemër *amen* «ne» + prapafjala *-θar* «prej», që shqiptohet [dar] pas një *n*-je). Faktikisht shumica dërrmuese e trajtave të shkruara mbulojnë një numër fort të madh realizimesh, siç është rasti midis të tjerash me shqiptimet shumë të ndryshme të prapafjaleve (sipas pozicionit e dialektit).

C) **Leksikologjike.** Sikurse edhe në nivelet e tjera, për zgjedhjen leksikale mbizotëron parimi i kuptueshmërisë optimale: rekomandohen fjalët më të përhapura (me kusht që të jenë vërtet rrome) përkundrejt atyreve të kufizuara te një grup i vogël të folmesh, duke qenë se janë atëherë të pakuptueshme jashtë tij.

Psh. nuk rekomandohet që të futet fjala *bagav* «këndoj» në gjuhën bazë të përbashkët, sepse njihet vetëm në disa rajone të Polonisë e të Bashkimit Sovjetik, ndërsa sinonimi i kësaj foljeje *gilabav* (me variantet *gilavav*, *gilabarav*) njihet gati kudo; natyrisht në një tekst letrar kushtuar rromëve të Polonisë (siç është rasti i vjershave të poeteshës rrome nga Polonia Papùša) apo të Bashkimit Sovjetik, nuk kundërshtohet përdorimi i dialektalizmit me tokshënim *bagav*, me një fusnotë shpjeguese.

Kur dy fjalë rrome bashkekzistojnë gjerësisht, si psh. *rikono* përpos *zukul* «qen» (që të dyja njihen nga Greqia e deri në Poloni), përdoren që të dyja. Vërtet në të kaluarën, ato ka pasur një diferencë kuptimore, duke qenë se në disa dialekte *rikono* ka ruajtur kuptimin i vjetër «këlysh»; nuk përjashtohet të rishfaqet më vonë specializimi kuptimor me *rikono* «këlysh» përpos *zukul* «qen i

rritur». Sot në shumicën e të folmeve, *krlo* shënon «grykë» e «zë(ri)» megjithatë kuptimi i parë ka qenë «grykë», kurse kuptimi «zër(ri)» shprehej me fjalën *zan*, e cila ende është në përdorim të gjerë ndër Rromët e Bielorusisë. Prandaj është e domosdoshme të korret kudo në Evropë thesari leksikor që rron ende në grupet e ndryshme të Rromëve, në mënyrë që të rihidhet në qarkullim të gjerë.

Toleranca dhe preferenca në fushën e leksikologjisë plotësohen njëra tjetrën. Këtu mund të theksojmë një diferencë midis trajtimit të fushës leksikore e atyreve shqiptimore e morfologjike në formimin e gjuhës letrare apo të përbashkët: ndërsa në fonologji e në morfologji rregullat veprojnë në mënyrë autonome e mjafton t'i përshkruajmë pa ndërhyrje njerëzore, vetëm duke theksuar koherencën e tyre, në leksikologji përkundrazi njeriu duhet në çdo hap të ndërhyjë për të trajtuar çdo element posaçërisht. Si pasojë, kodifikimi, i cili merret me fonetikën, fonologjinë e shkrimit, nuk kërkon as shumë kohë (disa vjet) as shumë mjete *sepse trajton sisteme të tërë*, normalizimi i leksikut kërkon jo vetëm më shumë kohë, por edhe më shumë bashkëpunëtorë sesa kodifikimi i fonologjisë apo morfologjisë, sepse çdo rast duhet studiuar dhe diskutuar posaçërisht, gjerësisht e në perspektivën e tërësisë së gjuhës, pa harruar kontekstin e jetës shoqërore.

D) *Sintaksore*. Në sintaksë si në nivele të tjera, qartësia dhe kuptueshmëria janë parime kryesore. Mund të shtojmë se hulumtimet në fushën e sintaksës rrome janë deri tani mjaft të rralla. Megjithatë, vihet re se dialektet rrome për sa i përket sintaksës, nuk dallohen midis tyre në një mënyrë aq të thellë që të shkaktojë mosmarreveshje, prandaj të gjitha strukturat sintaksore fillimisht pranohen në gjuhën e përbashkët. Nga praktika e shkrimtarëve do të dalë më vonë një profil sintakso-stilistik i përbashkët për gjuhën rrome, që do ta quajmë atëherë jo vetëm «qëndror» apo «të përbashkët» po edhe «letrar».

Duhet theksuar kështu se, përpos parimeve të qartësisë e të kuptueshmërisë, duhet respektuar edhe një parim tjetër: ai i konsekuencës së trajtave në ligjërim e në shkrim. Konsiston në kërkesën që të mos përzihen (pa nevojë stilistike) fjalë apo trajta të marra nga dialekte të ndryshme: psh. nëse dikush shqipton [sh'avo] për *çhavo* «djalë» do të shqiptojë gjithashtu [zh'anav] e jo [xhanav] për *zanav* «unë di», nëse përdor *xalem* «hëngra», duhet të përdorë gjithashtu *pilem* «piva» e jo *pilom* apo *pilum*, nëse përdor *asiav* «mulli» apo *paj* «ujë», duhet të përdorë gjithashtu *abiav* «dasmë» e jo *biav* etj... si dhe *khoj* «dhjamë» e jo *khoni* etj. Konsekuenca variantore rrjedh nga besnikëria e autorit karshi dialektit të vet amtar.

VIII. PERFUNDIME (shtojcë 2012)

Del në pah se themelet e gjuhës rrome të standardizuar ishin mjaft të përpunuar që në kohën kur u botua ky artikull, jo vetëm nga puna e Rromëve që përpiqeshin ta formojnë e ta ngrenë këtë standard, por nga vetë brumi i saj, i cili është shumë koherent në gojën e popullit. Problemet dalin kur gjuha rrome trajtohet nëpërmjet metodave të sajua apostafat për gjuhë të tjera, me strukturë të ndryshme nga ajo e romishtes ose kur hulumtuesi nuk është i aftë të marrë parasysh tërësinë e gjuhës, nxjerr përfundime nga një e folme lokale e tenton t'i imponojë tërësisë së romishtes. Një rrezik tjetër i shpeshtë është kur, nga paaftësia që të kuptojë logjikën e koherencën e brendshme të gjuhës – duke mos qenë folës i përditshëm i romishtes, tenton të imponojë konceptin se kemi jo një gjuhë rrome por shumë të tilla. Megjithatë impenjimi i Rromëve në studimet rrome, si edhe në krijimtari letrare, sidomos gjatë 20-30 viteve të fundit, po e ndërron rrënjësisht këtë situatë.

Burime të përdorura në këtë artikull:

Barannikov, A. P. and M. V. Sergievskij. 1938. *Цыганско-русский словарь*. Moskë.

Calvet, Georges. 1982. *Lexique tsigane, dialecte des Erlides de Sofia*. Paris. P. O. F.

Courthiade, Marcel. 1983. «Sur le problème de l'unité des parlers roms». In: *Studia Indo-Iranica* Nr 52:15-24. Poznań.

----. 1984. «Rromani Phonetics and Orthography». *Newletter GLSNA*. Nr 7 (4): 1-3. New-York.

- Ficowski, Jerzy. 1965. *Cyganie na polskich drogach*. Kraków.
- Pobożniak, Tadeusz. 1964. *Grammar of the Lovari Dialect*. Kraków (P. A. N.)
- Soravia, Giulio. 1981. *Vocabolario sinto delle Venezie*. In: *Lacio Drom*, Nr 17 (4-5): 2-57. Rome.